

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Wetiq/Dr. str. 1307  
Datë/Datëm. 15. 07. 2025  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



**Datë: 15.07.2025**

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve dhe individëve në fushat e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo-Qeveritare dhe individëve si vijon:
  - 2.1 Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
  - 2.2 Mjetet financiare për mbështetjen financiare tërhiqen nga kodi i subvencioneve për mbështetjen e entiteteve jopublike dhe individëve që promovojnë avancimin, fuqizimin dhe masovizimin e kulturës, rinisë dhe sportit;
3. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është **5 ditë** pune dhe fillon në ditën e publikimit të thirrjes publike. **Afati i fundit për dorëzim të projekt-propozimeve është deri me 21.07.2025**
4. Organizata Jo-qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi **një(1)** muaj dhe maksimumi tre **(6)** muaj.
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim.
6. Dokumentacioni i kompletuar në dy zarfe të mbyllura duhet të dorëzohet në adresën e komunës rruga 'Tahir Zemaj' në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e Komunës ose përmes postës. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në email-adresën [agron.breznica@rks-gov.net](mailto:agron.breznica@rks-gov.net).

7. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bënë komisioni vlerësues, nëse i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit një të vendimit.
8. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të Organizatave Jo-qeveritare.
9. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuesin e suksesshëm që mund të përkrahet nga kategoria e subvencioneve, projekti i të cilit i plotëson kushtet e financimit, udhëheqësi mbështetur në rekomandimin e Komisionit Vlerësues merr vendim për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo-qeveritare dhe individëve që merren me përkrahjen, fuqizimin dhe masovizimin e kulturës, rinisë dhe sportit.
10. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, rini dhe Sport e Komunës së Fushë-Kosovës.
11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Sqarim: OJQ-të dhe individët të cilat nuk i kanë mbyllur projektet paraprake (dorëzuar dëshminë e realizimit të projektit dhe raportin financiar) nuk do të shqyrtohen fare nga komisioni për vlerësim.**

**Akti i dorëzohet:**

- 1 x Kryetarit të Komunës**
- 1 x Drejtorisë së FB**
- 1 x Drejtorisë së KRS**
- 1 x Arkivit**

